

## Nisma #zgjidhje

9 shkurt 2021

### Zgjidhje për ujin e pijshëm në Kosovë

# UJI I PIJSHËM KA RËNDËSI JETIKE PËR QYTETARËT E KOSOVËS

Statistika/të dhëna nga hulumtimet e ndryshme dhe nga debati mbajtur më 5 shkurt nga #zgjidhje:

- Rreth 95% e ujit që konsumojmë vjen prej reshjeve atmosferike që mbushin 6 pika kryesore grumbulluese të ujit në Kosovë dhe pastaj shpërndahet përmes rrjetit (sistemit publik) të ujësjellësit deri te konsumatorët (qytetarët). Reshjet e pakëta nënkuptojnë mungesë uji.
- Statistikat e fundit tregojnë se rreth 85-90% të qytetarëve kanë qasje në rrjetin (sistemin) publik të ujit të pijshëm; por jo edhe ujë të pijshëm nga ky rrjet. Ka zona në Kosovë që nuk kanë qasje në ujë të pijshëm, as në ujësjellës (rrjet publik), as në puse. Në disa raste puset kanë ujë por të papastër dhe rrezikohet seriozisht shëndeti nëse përdoret pa u trajtuar.
- Cilësia e ujit të pijshëm nga sistemi publik është shumë e sigurt; më e sigurt se sa e ujit të pijshëm që shitet në shishe plastike të cilat dëmtojnë ambientin, e me këtë edhe shëndetin publik.
- Ndryshimet klimatike kanë efekt thelbësor, dhe parashikimet nga hulumtimet e ndryshme ndërkombëtare tregojnë që shtetet e zhvilluara e kanë vendosur si një nga prioritetet kryesore të tyre sigurimin e ujit të pijshëm, pasi që në 50 vitet e ardhshme parashikohet të ketë mungesë të theksuar.
- Uji i pijshëm nuk duket që është prioritet për subjektet politike garuese në zgjedhjet e 14 shkurtit.
- Uji i pijshëm bëhet temë diskutimi (aktualizohet) vetëm kur ka kriza të ujit të pijshëm (mungesë dhe/ose kufizime). P.sh. vjet (2020) kishte debate të rëndësishme për mungesën e ujit në rajonin e Gjilanit për shkak të mungesës së reshjeve.


Shembuj nga diskutimi në debatin e #zgjidhje:

- o Në Skënderaj është punuar shumë në trajtimin e problemit të ujit të pijshëm. Por zona e Drenicës thjeshtë, akoma ka mungesë uji; qytetarët hapin puse dhe nuk kanë ujë. Në atë rajon uji i pijshëm merr prioritet parësor, para të gjitha nevojave tjera siç mund të jenë arsimiti, punësimi, etj. P.sh. Penda e Kuçicës ka filluar si ide dhe është rishiku disa herë por kufizimet buxhetore të komunës e pamundësojnë realizimin e këtij projekti.
- o Në Fushë Kosovë, p.sh. një pjesë e madhe e banorëve nuk kanë qasje në ujë të pijshëm. Qytetarëve u duhet të shkojnë 3-4 kilometra nga vendbanimi i tyre për t'u furnizuar me ujë të pijshëm nga puset ose burimet e ujit që u mungojnë në shtëpitë dhe lagjet e tyre.
- o Ka lagje edhe në Prishtinë në të cilat qytetarët, për shkak të ndërtimeve të pa planifikuara mirë, kanë mungesë të ujit. Problem këtu është kapaciteti prurës i sasisë së ujit që është i kufizuar dhe lidhjet e paligjshme të ndërtesave/shtëpive të reja në rrjet.
- o Anketa e treguesve të shumfishtë (vitin e kaluar) nga UNICEF dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës, tregon që edhe pse në përqindje të ulët, në disa raste ka prezencë të bakteries E. coli në ujë të pijes që e përdorin qytetarët e Kosovës.

Kosova ka njohës/ekspert, kapacitete dhe mundësi për planifikim dhe trajtim afatgjatë të zgjidhjes së problemit të ujit të pijshëm por kërkohet konsensus dhe bashkëveprim ndërpartiak e ndërinstucional.

## Propozime për zgjidhje të mundshme:

1. Investimi në 6 pika kryesore (liqene artificiale) grumbulluese të ujit në Kosovë (përmirësim dhe mirëmbajtje).
2. Përmirësim të infrastrukturës (rrjetit) shpërndarëse të ujit të pijshëm, si dhe zbatim të drejtë të ligjit si për lejet e ndërtimit, shfrytëzimit të ujit (autolarjet, përdorimi i ujit të pijshëm për bujqësi; përdorimi nga bizneset e ndryshme për ftohje, prodhim të lëngjeve e arsye tjera; komercializimi i burimeve natyrore - shitja e ujit dhe pagesa e tatimit, etj).
3. Edukimi dhe vetëdijësimi për shfrytëzim të arsyeshëm të ujit të pijshëm; në çështje praktike si pastrimi, përdorimi për gatim, pastrim në amvisëri, etj., me synim ndryshimin e sjelljes në raport me përdorimin e ujit të pijshëm.
4. Trajtimi dhe kontrolli sistematik i cilësisë së ujit të pijshëm.
5. Ofrimi i informacionit të mjaftueshëm dhe të përditësuar (dhe komunikimi i rregullt me qytetarë përmes kanaleve të ndryshme) për sasinë e ujit të pijshëm, mungesën/kufizimet, cilësinë, shfrytëzimin, çmimin, etj. Sidomos metoda dhe kanale komunikimi dhe ofrim informacioni për grupe të ndryshme shoqërore, si dhe për gratë të cilat në 95% të rasteve janë përdoruese kryesore të ujit për nevoja të familjes (gatim, pastrim, etj).
6. Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë qytetarët (jo vetëm qasje në rrjet të ujit të pijshëm), dhe siguria e cilësisë së ujit të pijshëm (pastrimi nga ndotësit).
7. Të investohet në realizimin e projektit të Pendës së Kuçicës dhe në pendat tjera në komuna të ndryshme të Kosovës në të cilat ekzistojnë ose eksplorohen mundësi të tilla.
8. OJQ-të mund të luajnë rol kyç në vetëdijësim për ujin e pijshëm. Pra, një bashkëpunim më i ngushtë në mes të OJQ-ve në njërin anë dhe i OJQ-ve me institucione publike në Kosovë në anën tjetër, dhe me qytetarë në vendet në të cilat veprojnë.



#zgjidhje është iniciativë e përbashkët vullnetare e organizatave joqeveritare në Kosovë e cila synon që interesat e qytetarëve të jenë në qendër të debatit dhe programeve politike e qeverisëse të subjekteve politike garuese në zgjedhjet e 14 shkurtit. Për të përmbushur këtë synim, #zgjidhje do zhvillon ulumtime, analiza dhe debate të ndërmarra në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe profesionale

**#zgjidhje** është iniciativë e përbashkët e Aureola; Balkan Green Foundation; Debate Center - Qendra e Debatit; Global Shapers Community, Prishtina; iCHAT; Iniciativa e Pavarur e të Verbërve të Kosovës; Iniciativa Qytetare Skënderaj; Institute for Development Policy; IZHPS; Kosovo Advocacy Group; Lëvizja FOL; Mundësia, Mitrovicë; OJQ "Gruaja Hyjnore", Gjilan; OJQ "VISION 02", Istog; OJQ Gjeomjedisi; OJQ Nderi, Deçan; OJQ Ndërto të Ardhmen, Prishtinë; Partners Kosova; Qendra e Gruas "ATO", Vushtrri; Roma in Action, Gjakovë; The Balkan Forum.